



Raport Vjetor

Reflektime për Shërbimin në vitin 2024

Një vit arritjesh të para:
Lëmë gjurmë në histori
bashkërisht nëpërmjet
partneritetit dhe ndikimit



20

HISTORY MADE TOGETHER

24

PODGORICA

TIRANA

Përmbajtja:

➤ Mesazh nga Ambasadorja e SHBA-së në Mal të Zi.....	4
➤ Mesazh nga e Ngarkuara me punë e SHBA-së në Shqipëri.....	6
➤ Fjala përshëndetëse e Drejtoreshës për Shqipërinë & Malin e Zi.....	9
➤ Misioni i Korpusit të Pagues.....	12
➤ Korpusi i Pagues në Shqipëri.....	13
➤ Korpusi i Pagues në Mal të Zi.....	14
➤ Shërbimi vullnetar në vitin 2024.....	15
• <i>Mbështetja e komuniteteve në nevojë.....</i>	16
• <i>VKP-të e parë pas pandemisë përfundojnë shërbimin e tyre.....</i>	17
• <i>Një grup i ri vullnetarësh përfundon trajnimin dhe fillon shërbimin.....</i>	18
• <i>Trajnimi i Vullnetarëve gjatë shërbimit.....</i>	19
• <i>Vullnetarët jetojnë me familjet pritëse.....</i>	20
• <i>Rikonfirmimi i partneritetit me qeverinë malazeze dhe atë shqiptare.....</i>	21
• <i>Thellimi i bashkëpunimit me partnerët tanë.....</i>	22

Përmbajtja:

➤	Vështrim i përgjithshëm i Objektivave të KPSHMZ-së sipas sektorëve.....	23
➤	Zhvillimi organizativ.....	24
▪	<i>Shëndeti dhe mirëqenia e të rinjve.....</i>	<i>25</i>
▪	<i>Mësimdhënia e gjuhës angleze në Shqipëri.....</i>	<i>26</i>
▪	<i>Mësimdhënia e gjuhës angleze në Mal të Zi.....</i>	<i>27</i>
▪	Kampet verore në Shqipëri dhe Mal të Zi.....	28
▪	Prezantimi i kulturës dhe traditave - Histori nga vullnetarët.....	29
▪	<i>Një tradita prej komuniteteve malazeze.....</i>	<i>30</i>
▪	<i>Prezantojmë rreth ushqimit në Shqipëri.....</i>	<i>31</i>
▪	<i>Ndarja e informacioneve rreth aktiviteteve novatore prej Amerikës.....</i>	<i>32</i>
▪	Modele novatore shërbimi dhe shërbim i rikonceptuar	33
▪	<i>Shërbimi virtual në Shqipëri dhe Mal të Zi.....</i>	<i>33</i>
▪	<i>Komiteti i Përmirësimit të Shërbimit.....</i>	<i>34</i>
▪	<i>Rrjeti i Mbështetjes nga Kolegët.....</i>	<i>35</i>
▪	<i>Grupi i Punës për Komunikimet.....</i>	<i>36</i>

Përmbajtja:

- Operacionet në mbështetje të komuniteteve pritëse dhe Vullnetarëve të Korpusit të Paqes.....37
 - Mbështetja administrative efektive e operacioneve të Korpusit të Paqes..... 37
 - Shërbimet gjithëpërfshirëse mjekësore për Vullnetarët tanë..... 38
 - Siguria dhe sigurimi i Vullnetarëve të Korpusit të Paqes.....39
 - *Mbështetja e sigurisë dhe sigurimit të Vullnetarëve të Korpusit të Paqes..... 40*
 - *Fuqizimi i stafit përmes ekspertizës në siguri..... 41*
 - Stafi ynë i përhershëm gjatë vitit 2024..... 42
- Partnerët tanë - Çelësi i ndikimit tone..... 43

Të dashur miq,

Kam kënaqësinë të ndaj disa shënime rreth raportit të këtij viti nga Korpusi i Paqes, ku theksohen kontributet e rëndësishme të Vullnetarëve tanë dhe partnerëve të tyre në Malin e Zi. Modeli unik i zhvillimit të bazuar te komuniteti dhe marrëdhënieve ndërmjet personave, që mishërohen nga Korpusi i Paqes, ka bërë të mundur mirëpritjen e Vullnetarëve tanë në të gjithë vendin. Që nga veriu e deri në jug, ata janë ftuar të ndajnë ekspertizën e tyre, të mësojnë gjuhën angleze - gjuhën e mundësisë - dhe të mbështesin nismat për arsimimin dhe fuqizimin e të rinjve. Falë përpjekjeve të tyre të palodhura, ata kanë ndërtuar lidhje të thella dhe të qëndrueshme me komunitetet vendase.

Gjatë dy viteve të para të shërbimit në Malin e Zi, Vullnetarët e Korpusit të Paqes janë shndërruar në ambasadorë të vërtetë personalë të popullit amerikan, duke u bërë pjesë e gjuhëve dhe zakoneve vendase të komuniteteve ku kryejnë shërbimin e tyre. Nëpërmjet të jetuarit pranë familjeve malazeze dhe angazhimit me komunitetet e tyre, ata krijojnë mundësi për dialog kuptimplotë dhe mirëkuptim. Ky ndërveprim pasuron përvojën e Vullnetarëve, ndërsa u mundëson malazezëve një perspektivë të qartë se cilët janë amerikanët - pra, një popull i përbërë nga kombësi të ndryshme, i angazhuar ndaj partneritetit dhe respektit. Nëpërmjet ndërveprimeve, Vullnetarët zhbëjnë stereotipat dhe ndërtojnë besimin, duke ilustruar vlerat e empatisë, bashkëpunimit dhe komunitetit, që përbëjnë pjesë thelbësore të frymës amerikane.

Dëshiroj të vlerësoj në mënyrë të veçantë grupin e parë të Vullnetarëve të Korpusit të Paqes, që sapo kanë përfunduar shërbimin e tyre në Malin e Zi. Angazhimi dhe përpjekjet e tyre kanë ngritur një themel të qëndrueshëm për Vullnetarët pasardhës, duke siguruar se trashëgimia e partneritetit dhe shërbimit do të vijojë me sukses.

Mesazh nga Ambasadorja e SHBA-së në Mal të Zi, Judy Rising Reinke



Këtë vit, pata nderin të mirëprisja Drejtoresh e Korpusit të Paqes Carol Spahn gjatë vizitës së saj në Malin e Zi, ku kremtuam sukseset e arritura nga Vullnetarët tanë në vitin e tyre të parë të shërbimit. Së bashku, diskutuam planet emocionuese për Korpusin e Paqes në Malin e Zi, me synimin për ta shtrirë praninë e Vullnetarëve tanë në mbarë vendin. Kjo shtrirje do të na mundësojë mbulimin e zonave të nënshërbyera dhe fuqizimin e ndikimit tonë sa i përket arsimit të rinjve dhe zhvillimit të komuniteteve. Krahas kësaj, kam pasur privilegjin të vizitoj disa nga Vullnetarët tanë të përkushtuar dhe të shoh nga afër ndikimin e tyre në komunitetet përkatëse. Mund ta pohoj personalisht se këta persona të mrekullueshëm kanë qenë përfaqësues të shkëlqyer të vlerave amerikane dhe përkrahës të respektit reciprok dhe kompetencës ndërkulturore. Puna e tyre promovon shkëmbimin e njohurive dhe respekton larminë e të gjitha kulturave, duke ndihmuar në avancimin e drejtësisë dhe zhvillimit rrënjësor. Ndihej vërtet e frymëzuar nga përgjegjshmëria dhe përkushtimi i tyre, sikurse ndihem e nderuar dhe falënderuese për mbështetjen e vazhdueshme të partnerëve tanë malazezë.

Ndërsa kremtojmë këto arritje, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të thellë ndaj popullit malazez, që i ka mirëpritur Vullnetarët tanë amerikanë, dhe ndaj të gjithë bashkëpunëtorëve të zellshëm, që na kanë ndihmuar të sjellim ndryshim në komunitetet e tyre.

Ju falënderoj për mbështetjen tuaj të vyer, dhe ju përgëzoj për Raportin Vjetor për vitin 2024!

Sinqerisht,

Judy Rising Reinke

Mesazh nga Ambasadorja e SHBA-së në Mal të Zi, Judy Rising Reinke



Të dashur miq,

Ndërsa reflektojmë për një tjetër vit bashkëpunimi kuptimplotë dhe shërbimi të frytshëm në Shqipëri, kam nderin të mbaj fjalën përshëndetëse për raportin vjetor të vitit 2024 të Korpusit të Paqes në Shqipëri dhe Mal të Zi (KPSHMZ). Këtë vit, 44 Vullnetarë të përkushtuar kanë shërbyer në komunitete në mbarë Shqipërinë, duke u fokusuar te mësimi i anglishtes dhe edukimi shëndetësor, si dhe te zhvillimi organizativ. Vullnetarët kanë ndjekur mbi 500 orë trajnimi të mundësuar nga Korpusi i Paqes, që përfshinte njohuri për shqipen, trajnim teknik dhe mirëkuptim ndërkulturor. Së bashku me partnerët e tyre shqiptarë, ata kanë përballuar sfidat dhe arritur suksese, duke shpalosur frymën e mirëkuptimit reciprok dhe bashkëpunimit, që Korpusi i Paqes përfaqëson.

Puna e Korpusit të Paqes përputhet me strategjinë shqiptare të reformimit të arsimit, veçanërisht sa i përket zbatimit të kurrikulës bazë në arsimin parauniversitar. Nëpërmjet fokusimit te njohuritë për shqipen dhe te zhvillimi i të rinjve, Vullnetarët e KPSHMZ-së mbështesin objektivin kombëtar të lidhjes së arsimit me nevojat e tregut të punës. Kërkesa për gjuhën angleze në ekonominë globale është e pamohueshme, dhe përpjekjet e Korpusit të Paqes ua bëjnë më të lehtë nxënësve dhe studentëve që të jenë të suksesshëm në këtë peizazh konkurrues. Krahas kësaj, ndërsa Ministria e Arsimit dhe Sportit nis zbatimin e "*Programit Kombëtar për Zhvillimin Profesional të Mësuesve*", Vullnetarët e Korpusit të Paqes përmirësojnë metodologjitë e mësimdhënies nëpërmjet përfshirjes së tyre në klasat në mbarë vendin. Gjithashtu, vullnetarët e KPSHMZ-së ofrojnë mbështetje ndaj bashkive dhe organizatave të bazuara te komuniteti për të arritur objektivat e tyre në nivelin vendor. Ky është një shembull se si puna së bashku na ndihmon të kemi arritje më të shumta.

Përvoja ime në Shqipëri është ende në fillimet e saj, por idenë e vullnetarizmit e njoh shumë mirë. Gjatë muajve të mi të parë në vend, pata kënaqësinë të takoja disa Vullnetarë të Korpusit të Paqes, përkushtimi i të cilëve ka qenë vërtet frymëzues. Ata janë duke krijuar një ndikim domethënës në fushat kryesore, si mësimdhënia e gjuhës angleze, shëndeti dhe mirëqenia e të rinjve dhe zhvillimi organizativ.

Mesazh nga e ngarkuara me punë e SHBA-së në Shqipëri Nancy VanHorn



Embassy of the United States of America
Tirana, Albania
November 22, 2024

Dear Friends and Partners,

As we reflect on another year of meaningful collaboration and impactful service in Albania, I am honored to offer an opening letter to the 2024 annual report of Peace Corps Albania and Montenegro (PCAM). This year, 44 dedicated volunteers have served in communities across Albania. Through on-the-ground and health education, leadership training, and civic education, these volunteers have delivered more than 500 hours of training, and critical cultural understanding. Together with their Albanian partners, they have navigated challenges and celebrated successes, embodying the spirit of mutual understanding and cooperation for which the Peace Corps stands.

Peace Corps work closely aligns with Albania's education strategy, particularly the implementation of the core curriculum in primary education. By focusing on English language skills and math development, PCAM volunteers support the national goal of raising education to labor market needs. The demand for English in the global economy is undeniable, and Peace Corps offers a unique way to help students in Albania and the "National Response for the Professional Development of Teachers" (NRRP) initiative. In addition, PCAM volunteers also support the Ministry of Education and Sports (MEST) in addressing challenges through their involvement in local-based organizations in achieving their goals on a local level. This exemplifies how by working together, we can achieve more.

I am new to Albania, but not new to the idea of volunteerism. In my first months here, I had the pleasure of meeting several Peace Corps volunteers whose dedication truly inspires me. They are making a meaningful impact in key areas such as English education, youth health and well-being, and organizational development.

Mesazh nga e Ngarkuara me punë e SHBA-së në Shqipëri, Nancy VanHorn

Nëpërmjet punës së tyre, ata i ndihmojnë fëmijët dhe të rinjtë të përmirësojnë shëndetin dhe aftësitë e tyre për jetën, të zhvillojnë njohuritë në gjuhën angleze dhe të fuqizojnë organizatat vendore. Është e mrekullueshme të shohësh se si Vullnetarët ndërtojnë marrëdhëniet dhe promovojnë shkëmbimin e njohurive, duke nxitur një njohje më të thellë të kulturave tona dhe duke frymëzuar ndryshimin pozitiv të komuniteteve.

Ndërsa përparojmë, duhet të vazhdojmë ta frymëzojmë njëri-tjetrin dhe të ndërtojmë një të ardhme më të shndritshme, të mbështetur te besimi dhe bashkëpunimi. I shpreh mirënjohjen time të thellë popullit shqiptar, që ka mirëpritur Vullnetarët e Korpunit të Paqes, dhe kolegëve tanë shqiptarë, që kanë bashkëpunuar me Korpunit e Paqes për më shumë se 30 vjet. Mbështetja dhe bashkëpunimi juaj qëndrojnë në themel të suksesit tonë të përbashkët, dhe presim ta vazhdojmë së bashku këtë udhëtim.

Faleminderit për partneritetin tuaj,

Nancy VanHorn



Fjala përshënde tëse e Drejtores për Vendin: Megan Wilson

Të dashur miq,

Viti 2024 ka qenë një vit i mbushur me arritje të para, partneritet, ndikim dhe tranzicion. Pavarësisht tranzicioneve, lidhja e fuqishme ndërmjet Vullnetarëve tanë dhe komuniteteve që u shërbejmë vijon të jetë e njëjtë. Kjo lidhje pasqyron angazhimin tonë ndaj partneritetit dhe bashkëpunimit për tejkalimin e sfidave bashkërisht.

Në Shqipëri dhe në Malin e Zi, Vullnetarët e Korpusit të Paqes janë një lidhje kryesore, që nxit gjetjen e zgjidhjeve vendore ndaj nevojave zhvillimore, duke krijuar njëkohësisht marrëdhënie miqësore. Ata punojnë bashkë me anëtarët e komuniteteve për të përmirësuar mirëqenien dhe shëndetin, për t'u përshtatur me mjediset në ndryshim dhe për të promovuar rritjen ekonomike në nivel rrënjësor. Këtë vit, Vullnetarët tanë vijuan traditën e Korpusit të Paqes të fokusimit tek arsimimi dhe fuqizimi i të rinjve, duke bashkëpunuar për të krijuar drejtues dhe mundësi të reja për brezin e ardhshëm të agjentëve të ndryshimit. Puna jonë në Shqipëri është shtrirë në tre sektorë: **Zhvillimi organizativ, Arsimi, Shëndeti dhe mirëqenia e të rinjve, dhe në sektorin kyç të Arsimit në Malin e Zi.**



Mesazh nga Drejtorja për Vendin

Sa u përket arritjeve të para, në vitin 2024 patëm krenarinë të kremtonim grupin e parë të Vullnetarëve pas pandemisë, që përfunduan dy vite shërbimi. Dëshiroj të vlerësoj në mënyrë të veçantë punën e zellshme dhe angazhimin e Vullnetarëve tanë, që ishin të parët që shërbyen në Malin e Zi, përpjekjet e të cilëve kanë ngritur themele të qëndrueshme për shërbimin në të ardhmen, duke siguruar se trashëgimia e partneritetit tonë do të vijojë të lulëzojë.

Jemi veçanërisht të lumtur që katër nga Vullnetarët prej grupit të parë pas pandemisë do ta vijojnë shërbimin e tyre në komunitetet vendase në Shqipëri, ndërsa dy të tjerë do të transferohen te programe të tjera të Korpusit të Paqes në botë. Këto zgjedhje pasqyrojnë ndikimin transformues të përvojave të tyre dhe fuqinë e shërbimit, si një dëshmi e misionit tonë të përbashkët.

Përshtypjet e ndara nga partnerët tanë gjatë takimeve të ndryshme nxjerrin në pah një pikë të përbashkët: Korpusi i Paqes në Shqipëri dhe Mal të Zi ndërton dhe mban marrëdhënie kuptimplota, duke fuqizuar praninë e Amerikës në nivelin e komunitetit. Njëkohësisht, ne mbajmë marrëdhënie të qëndrueshme në nivelet më të larta të qeverisë, duke ngritur partneritete efektive me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në Shqipëri dhe me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit në Malin e Zi. Jam e lumtur që Drejtorja e Korpusit të Paqes, Znj. Spahn, shprehu sërish vlerësimin tonë ndaj partnerëve qeveritarë, duke përfshirë të dyja Ministret e Arsimit, gjatë vizitës së saj në Rajon në muajin maj, pas rinovimit të Memorandumeve të Mirëkuptimit në të dyja vendet në vitin 2024.

Mesazh nga Drejtorja për Vendin



Ndikimi i Vullnetarëve tanë në Malin e Zi ka qenë i mbresëlënës. Gjatë këtij viti, 12 Vullnetarë të përkushtuar punuan me të rinjtë vendas, duke organizuar bashkërisht aktivitete që përfshinë 586 të rinj, si dhe përmirësuan aftësitë e gjuhës angleze të 2.054 nxënësve në shkolla. Arsimi mbetet një gur themeli i misionit të Korpusit të Paqes, dhe ndërsa shohim drejt së ardhmes, kuptojmë se nevoja për njohjen e gjuhës angleze është në rritje në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur. I jemi gjithashtu mirënjohës MASHI-së për lehtësimin e zhvendosjes sonë në një zyrë të re në Podgoricë.



Ndikimi ynë në Shqipëri gjatë vitit 2024 tregoi se, në sektorin e zhvillimit organizativ, 14 Vullnetarë drejtuan bashkërisht përpjekje për të rritur mundësitë për angazhim qytetar, duke mbështetur 44 organizata të komunitetit dhe duke bashkorganizuar 142 aktivitete, që nxitën përfshirjen e komunitetit dhe drejtimin. Kjo frymë bashkëpunuese bëri të mundur zbatimin e 142 projekteve domethënëse, duke sjellë ndikim pozitiv për 2.428 pjesëmarrës në komunitete të ndryshme. Në sektorin e shëndetit dhe mirëqenies së të rinjve, 17 Vullnetarë bashkëpunuan me 265 punonjës shkollorë, duke ndjekur teknika novatore për bashkëlehtësimin e zbatimit të një kurrikule të drejtë gjinore për aftësitë e shëndetit dhe jetës, ku u angazhuan 4.193 pjesëmarrës nëpërmjet seancave të trajnimit individuale dhe në grupe të vogla. Programi ynë i mësimdhënies së gjuhës angleze pati shumë sukses, falë mbështetjes së 16 Vullnetarëve, që fuqizuan 193 mësues dhe angazhuan 3.679 nxënës nëpërmjet mësimëve të zhvilluara në bashkëpunim dhe pasurimit të veprimtarive për zhvillimin e të rinjve, duke përmirësuar ndjeshëm aftësitë e tyre në gjuhën angleze.

Mesazh nga Drejtorja për Vendin

Korpusi i Paqes në Shqipëri dhe Mal të Zi vijon t'i qëndrojë angazhimit për përgjigjshmërinë dhe llogaridhënien ndaj partnerëve të komunitetit, përmirësimit të angazhimit tonë me të rinjtë dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës kritike të nevojshme për mbështetjen e shërbimit të Vullnetarëve sa i përket shëndetit, sigurisë dhe mbështetjes teknike.

Ndërsa lëmë pas këtë vit, dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë ndaj partnerëve të komunitetit, mësuesve, prindërve, nxënësve dhe familjeve pritëse, që bashkëpunuan me Vullnetarët e Korpusit të Paqes gjatë vitit 2024. Gjithashtu, shprehim urimet tona më të mira për kolegët që u larguan nga KPSHMZ-ja për ta vazhduar rrugëtimin e tyre gjetkë, si Jeff Warner, Genti Leka dhe Rikela Fusha.

Ju falënderojmë për mbështetjen dhe besimin tuaj të vazhdueshëm ndaj punës sonë të përbashkët drejt paqes dhe marrëdhënieve miqësore në mbarë botën.

Me mirënjohje të thellë,



Misioni dhe objektivat e Korpusit të Paqes

Në vitin 1961, presidenti John F. Kennedy themeloi Korpusin e Paqes për të nxitur të kuptuarit më të mirë dhe për të promovuar miqësinë mes amerikanëve dhe popujve të tjerë.

Misioni i Korpusit të Paqes është të nxisë paqen dhe miqësinë në botë, duke përmbushur tre qëllime:

1. Të ndihmojë popullin e shteteve të interesuara të përmbushë nevojat për burra dhe gra të aftësuar.
2. Të ndihmojë në promovimin e të kuptuarit më të mirë të amerikanëve nga ana e popujve që u shërben.
3. Të ndihmojë në promovimin e të kuptuarit më të mirë të popujve të tjerë nga amerikanët.

Korpusi i Paqes ndryshon jetë; jetët e njerëzve në komunitetet në të gjithë botën dhe jetët e vullnetarëve.

- Më shumë se 240.000 amerikanë kanë shërbyer në Korpusin e Paqes në 142 vende.



Korpusi i Paqes në Shqipëri

Në vitin 1991, qeveria Shqiptare ftoi SHBA-në të krijonte një program të Korpunit të Paqes në vend. Grupi i parë i Vullnetarëve mbërriti në Shqipëri në vitin 1992 për t'u angazhuar me mësimdhënien e anglishtes në shkolla të arsimit të mesëm dhe në universitete. Nga viti 1993 deri në vitin 1996, katër grupe të tjera Vullnetarësh mbërritën për të dhënë mësim në anglisht, për të mbështetur zhvillimin e bizneseve të vogla ose për të mbështetur menaxhimin e bujqësisë dhe pyjeve. Korpusi i Paqes mbylli programin e tij në Shqipëri në vitin 1997 për shkak të trazirave politike dhe shqetësimeve për sigurinë e Vullnetarëve.

Qeveria shqiptare ftoi Korpunit e Paqes të rihapte programin e tij në vitin 2002 dhe mori pjesë në një vlerësim të zhvilluar nga Korpusi i Paqes. Bazuar në këtë vlerësim, anëtarët e parë të Korpunit të Paqes u kthyen në mars të vitit 2003, ngritën një zyrë dhe rihapën programet. Vullnetarët kanë punuar me qeveritë vendore, OJQ-të, shkollat dhe institucionet shëndetësore në tri fusha projekti:

- Mësimdhënia e gjuhës angleze
- Shëndeti dhe mirëqenia e të rinjve
- Zhvillimi organizativ

Programi i Korpunit të Paqes në Shqipëri operon sipas marrëveshjes ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë, që njeh rëndësinë e zhvillimit të marrëdhënieve të përfuturit reciprok dhe bashkëpunimit. Gjatë viteve, Korpusi i Paqes e ka çmuar thellësisht bashkëpunimin dhe dashamirësinë e popullit shqiptar. Ky partneritet është jetik për realizimin e nismave arsimore dhe zhvillimore dhe për krijimin e marrëdhënieve miqësore dhe mirëkuptimit ndërmjet kulturave. Që nga shtatori i vitit 1992, rreth 1000 vullnetarë kanë shërbyer në Shqipëri.



Korpusi i Paqes në Mal të Zi

Në vitin 2019, Korpusi i Paqes nënshkroi një marrëveshje dypalëshe me qeverinë e Malit të Zi, duke bërë të mundur zbatimin e një programi në vend. Grupi i parë i Vullnetarëve në trajnim mbërriti në janar të vitit 2020 dhe filloi trajnimin 10-javor para shërbimit. Fatkeqësisht, në mars të vitit 2020, grupi u evakuua për shkak të pandemisë së COVID-19-s përpara mbërritjes në komunitetet pritëse.

Pas përgatitjeve rigoroze, Vullnetarët u rikthyen në Malin e Zi në vjeshtë të vitit 2022. Pas një periudhe trajnimi të suksesshme, ata filluan për herë të parë kryerjen e shërbimit në komunitetet malazeze. Ky rikthim përbën një triumf të rëndësishëm ndaj sfidave të hasura gjatë periudhës pararendëse prej dy vite e gjysmë, duke ringritur misionin e Korpusit të Paqes dhe duke theksuar angazhimin serioz ndaj shkëmbimit ndërkulturor dhe zhvillimit të komunitetit. Në vjeshtë të vitit 2023, një grup tjetër Vullnetarësh në trajnim mbërriti në Mal të Zi dhe filloi shërbimin në dhjetor të po atij viti. Aktualisht, 11 Vullnetarët në komunitetet malazeze janë fokusuar te mësimdhënia e gjuhës angleze në bashkëpunim me homologët e tyre vendas.

Programi i Korpusit të Paqes në Malin e Zi është ngritur me ftesën e qeverisë malazeze dhe operon sipas një marrëveshjeje që thekson rëndësinë e ndërtimit të marrëdhënieve me përfitim reciprok dhe bashkëpunimit. Kemi kënaqësinë të mirëpresim grupin e ri të Vullnetarëve në janar të vitit 2025 dhe të shtrijmë përpjekjet tona në komunitete të reja, duke rritur më tej ndikimin tonë dhe duke fuqizuar partneritetin tonë.

Shërbimi në vitin 2024

- 58 Vullnetarë të Korpusit të Paqes në
 - 11 në Mal të Zi
 - 47 në Shqipëri
- 4 sektorë
 - Mësimdhënia e gjuhës angleze në Shqipëri
 - Mësimdhënia e gjuhës angleze në Mal të Zi
 - Edukimi shëndetësor
 - Zhvillimi organizativ
- Vazhdimësia e partneritetit me shkollat, bashkitë, ministrinë dhe OJF-të, dhe kalimi i fokusit në komunitete më të vogla, që kanë më pak burime.
- Vëmendja e shtuar ndaj çështjeve të lidhura me shëndetin dhe mirëqenien e të rinjve, përvetësimin e gjuhës angleze dhe fuqizimin e shkollave, zhvillimin e turizmit dhe qëndrueshmërinë e projekteve nëpërmjet pronësisë dhe mbështetjes vendore.



KPSHMZ-ja mbështet komunitetet nënevojë



Në Rožaje

Ne shërbejmë në zona të ndryshme të Shqipërisë dhe Malit të Zi, dhe i caktojmë Vullnetarët në shkolla, bashki, OJF dhe në organizata të tjera të qeverisjes vendore. Gjatë vitit 2023 dhe 2024, ekipi i Programit të Korpusit të Paqes në Shqipëri dhe Mal të Zi ka vendosur kontakt me 66 komunitete të vogla të reja. Qasja jonë krijon mundësi për Vullnetarët, që shërbejnë në komunitete të vogla ose fshatra, që të punojnë herë pas here me çështje rajonale, duke shfrytëzuar burimet e qytezave më të mëdha pranë tyre.

Korpusi i Paqes në Shqipëri dhe Mal të Zi ndjek një qasje të bazuar te nevojat sa i përket caktimit të Vullnetarëve. Filozofia e Korpusit të Paqes është të shërbejë në komunitetet me mungesë burimesh apo në popullatat e nënshërbyera, me qëllim mbështetjen e anëtarëve duke u ofruar aftësi që kanë gjasë të mundësojnë zhvillimin e komunitetit, si hartimi dhe menaxhimi i projekteve, drejtimi nga të rinjtë, aftësitë për jetën, gjuha angleze, mirëqenia dhe aftësi të ngjashme.



Në Kallmet, qarku Lezhë

Vullnetarët e parë pas pandemisë përfundojnë shërbimin e tyre

Konferenca e parë e Përmbylljes së Shërbimit (PSH) pas disa vitesh në Vendndodhje nuk ishte thjesht një aktivitet i mbushur me detyra administrative, por edhe një hapësirë ku Vullnetarët dhe stafi mund të reflektonin rreth përvojave të përjetuara.

Vullnetarët u ftuan të mendonin dhe ndanin përshtypjet e tyre rreth mundësive të ardhshme, të merrnin në konsideratë përfitimet dhe sfidat që hasen pas shërbimit dhe të mësonin se si të ruanin lidhjen me Korpusin e Paqes pas përfundimit të shërbimit.

Gjithashtu, Vullnetarëve u rikujtua angazhimi i tyre ndaj misionit të Korpusit të Paqes për marrëdhënie miqësore dhe paqe në botë, nëpërmjet Objektivit të Tretë: *Të ndihmojë në promovimin e të kuptuarit më të mirë të popujve të tjerë nga amerikanët*. Për dy vite, ata ndërморën përpjekje të konsiderueshme në kuadër të dy objektivave të parë, por misioni i tyre për të ndarë informacione rreth vendeve pritëse fillon vërtet pas kthimit në SHBA. Nga konferenca e PSH-së mësuam se Vullnetarët tanë kanë histori të shumta pozitive për të ndarë me amerikanët dhe botën për Shqipërinë dhe Malin e Zi, pra shërbimi i tyre nuk përfundon me largimin nga vendi i shërbimit.



Grupi i parë i Vullnetarëve të Korpusit të Paqes pas pandemisë, që filloi shërbimin në dhjetor të vitit 2022, e përfundoi shërbimin dyvjeçar të Korpusit të Paqes në vitin 2024. Nga 17 Vullnetarë, katër e shtynë shërbimin në Shqipëri me një vit shtesë, dy do të shërbejnë në vende të tjera, ndërsa pjesën tjetër e presin përvoja të reja.

Një grup i ri vullnetarësh përfundon trajnimin dhe fillon shërbimin



42 Vullnetarë të rinj mbërritën në Vendndodhje në tetor të vitit 2023. Pas një jave seancash Orientimi, ata u dërguan në komunitetet e trajnimit ku ndoqën trajnimin para shërbimit (TPSH) prej 10-11 javësh. TPHS-ja jonë e bazuar te komuniteti është një trajnim intensiv i fokusuar te të nxëniti rreth gjuhës dhe kulturës vendase, gjatë jetesës me një familje pritëse, si dhe tek aftësitë teknike të nevojshme për punën e mëpasshme të Vullnetarëve në vendet e shërbimit. Gjatë kësaj periudhe, Vullnetarët u bënë bashkë në katër raste për trajnimet në qendër, që mbuluan tema lidhur me sigurinë, sigurimin, mjekësinë, përvojat ndërkulturore, politikat e Korpunit të Paqes, etj.

Pjesëmarrësit në TPHS u caktuan si Vullnetarë në fillim të muajit dhjetor 2023. Vullnetarët u njohën me vendin e përcaktuar vetëm pak ditë para dhe u takuan me homologët vendas në Konferencën dyditore të Homologëve. Homologët i prezantuan Vullnetarët me vendndodhjet e reja, Agjencitë Pritëse dhe Familjet Pritëse. Në janar të vitit 2024, ata e filluan vitin e ri në vendet përkatëse të shërbimit, duke punuar me agjencitë pritëse.



Trajnimi i Vullnetarëve gjatë shërbimit të tyre

Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi është angazhuar në trajnimin e vazhdueshëm të Vullnetarëve. Pas 11 javësh të trajnimit para shërbimit, në shumë raste ne i ftojmë Vullnetarët të kthehen nga vendet e tyre për trajnim të mëtejshëm dhe shkëmbimin e përvojave të tyre pas një periudhe të caktuar, përveç mundësive të shumta të mësimit në internet dhe burimeve të tjera të disponueshme për ta. Trajnimet tona janë gjithëpërfshirëse dhe janë hartuar për të pajisur Vullnetarët me aftësitë, njohuritë dhe instrumentet e nevojshme për të shërbyer në komunitete të larmishme në të dy vendet.

Përveç përqendrimit teknik tek aftësitë dhe ekspertiza e nevojshme që secili Vullnetar të përmbushë me sukses rolin e tij, gjatë këtyre trajnimeve mbulohen një sërë temash, duke përfshirë:

- Kulturën e vendit pritës;
- Progresin e të nxëniet të gjuhës;
- Tema të lidhura me shëndetësinë dhe mjekësinë;
- Trajnimin për sigurinë dhe sigurimin për të zbutur risqet;
- Tema teknike për të përmirësuar aftësitë e tyre për të bërë punën.

Njëri prej trajnimeve i titulluar ‘Hartim dhe Menaxhim Projekti (HMP)’ është i hapur edhe për anëtarët e komunitetit, qofshin këta homologët parësorë të Vullnetarëve ose anëtarë të tjerë të komunitetit të gatshëm të bashkojnë forcat me Vullnetarët për të trajtuar nevojat më të ngutshme të vendit.



Vullnetarët jetojnë me Familjet Pritëse

Your relationships will run much deeper, and you will probably start behaving like one of their tribe.

Volunteer

Vullnetarët në Shqipëri dhe Mal të Zi vendosen në familje pritëse për periudhën e trajnimit para shërbimit dhe për një periudhë gjashtëmuajore në qytetin ose fshatin ku janë emëruar për dy vitet në vijim. Vullnetarët konsiderohen si pjesëtarë të rinj të familjes. Procesi i përshtatjes kërkon durim, kuptim dhe fleksibilitet nga të dyja palët. Kushtet e banimit lehtësojnë përshtatjen dhe shkëmbimin kulturor dhe promovojnë përvetësimin e gjuhës, integrimin e vullnetarëve në komunitetin lokal dhe sigurinë dhe sigurimin e vullnetarëve.

Vendosja e vullnetarëve tanë me familjet pritëse është një mënyrë që Korpusi i Paqes dhe agjencia pritëse t'u ofrojë atyre më shumë mundësi për të krijuar lidhje me komunitetin, përveç kolegëve të tyre, dhe për t'i ndihmuar Vullnetarët të mësojnë më shumë për qytetin ku janë vendosur dhe normat sociale përmes syve të të tjerëve, jo vetëm nëpërmjet kolegeve në vendin e punës.

Të nxënit dhe të kuptuarit të shoqërisë vendase, traditave, normave familjare dhe roleve të pjesëtarëve të familjes në qytetin e Vullnetarëve do t'i japë atyre një mundësi të vlefshme për t'i shërbyer komunitetit të tyre në mënyrën më efektive gjatë muajve në vijim. Vullnetarët nxiten që të mos i shohin familjet pritëse vetëm si burime kulturore, por edhe si burim për mbështetje personale.



Një Vullnetar me FP-në

Rikonfirmimi i partneritetit me qeverinë shqiptare dhe atë malazeze



Nënshkrimi i MM-së në Mal të Zi

Ministria e Arsimit dhe Sportit është parteri ynë qeveritar më i ngushtë në Shqipëri. Gjatë tre dekadave të fundit, ky partneritet ka qenë shembulli i bashkëpunimit dhe progresit, duke ndryshuar thellësisht jetën e Vullnetarëve dhe komuniteteve vendase. Më 23 prill 2024, ne e rikonfirmuam këtë partneritet me rinovimin e Memorandumit të Mirëkuptimit.

Së bashku ne kemi qenë dëshmitarë të fuqisë së arsimit. Vullnetarët tanë, krahas mësuesve të përkushtuar shqiptarë, kanë mbështetur zhvillimin e të rinjve shqiptarë nëpërmjet mësimave të gjuhës shqipe dhe mësimave të edukimit shëndetësor. Në këtë mënyrë, ne kemi hedhur themelet e një brezi të aftë akademikisht dhe të pajisur me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të qenë të suksesshëm.

Ndërsa ndërmarrim sërish këtë udhëtim, le të kremtojmë rëndësinë e përpjekjeve tona të përbashkëta për më të mirën për nxënësit dhe mësuesit tanë!

KPSHMZ dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit (MASHI) e Malit të Zi rinovuan Memorandumin e Mirëkuptimit (MM) më 6 mars 2024. Ky dokument parashtron qëllimet dhe objektivat tona të përbashkëta, duke i hapur kështu rrugën bashkëpunimeve të ardhshme duke mbështetur shkollat, mësuesit dhe komunitet në Malin e Zi. KPSHMZ është jashtëzakonisht shumë mirënjohëse MASHI-së për mbështetjen e tyre, duke përfshirë edhe ofrimin e një hapësire për zyra për të mbështetur operacionet tona në Malin e Zi.

Partneriteti ynë i fortë vazhdon të forcohet çdo ditë e më shumë, teksa Vullnetarët e Korpusit të Paqes bashkëpunojnë me shkollat dhe komunitetet malazeze. Ky MM hap rrugën për përparimin e mësimi të gjuhës angleze në Malin e Zi, si dhe për shkëmbimet kulturore midis malazezëve dhe amerikanëve nëpërmjet mësimdhënies së gjuhës angleze, ndarjes së njohurive, aftësive dhe kulturës amerikane, ndërkohë që mësojnë edhe për Malin e Zi dhe kulturën e tij.



Nënshkrimi i MM-së në Shqipëri

935 Vullnetarë në Shqipëri dhe **23** Vullnetarë në Malin e Zi kanë shërbyer kryesisht në komunitete rurale duke mbështetur nxënësit, mësuesit dhe shkollat. Aktualisht, **10** Vullnetarë po shërbejnë në Malin e Zi dhe **44** po shërbejnë në Shqipëri

Bashkëpunimi me partnerët tanë

Shërbimi në vitin 2024



Nënshkrimi i MM-së me Junior Achievement Shqipëri

Pas një periudhe të gjatë bashkëpunimi, Korpusi i Paqes Shqipëri dhe OJQ-ja Junior Achievement Shqipëri kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi.

Marrëveshja e bashkëpunimit fokusohet në trajnimin e Vullnetarëve të Korpusit të Paqes në zbatimin e programeve të Junior Achievement në shkollat partnere të interesuara në Shqipëri.

Vullnetarët e Korpusit të Paqes kanë bashkuar forcat me programin Junior Achievement për të fuqizuar të rinjtë në fusha si aftësitë e punësueshmërisë, zhvillimi i karrierës, të folurit në publik, kërkim dhe shkrim, puna në ekip dhe drejtimi. Ky partneritet është një tjetër hap i rëndësishëm në krijimin e një të ardhme më të ndritur për të rinjtë në Shqipëri duke i pajisur ata me aftësitë themelore dhe duke i ofruar mundësi për t'u rritur.

KPSHMZ ka thelluar bashkëpunimin me Kabinetin e Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor. Ky bashkëpunim është i përqendruar kryesisht në garantimin e efikasitetit të vendosjes së Vullnetarëve në bashkitë shqiptare, në mënyrë që të ofrojnë kontribute me ndikim në zhvillimin vendor.

Kjo strukturë do të jetë ndërlidhësi mes KPSHMZ-së dhe bashkive të interesuara. Korpusi i Paqes angazhohet të kontribuojë në përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve duke ofruar trajnime ose burime shtesë nga të cilat mund të përfitojnë si stafi i bashkive ashtu edhe Vullnetarët tanë.



Takim me Z. Mazniku, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor,

Synimet e vitit 2024 sipas sektorëve

Edukimi shëndetësor

1. Shtimi i njohurive dhe aftësive të fëmijëve dhe të rinjve për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e tyre përmes edukimit shëndetësor dhe aftësimit për jetën.

2. Shtimi i kapaciteteve të stafit shkollor për të ofruar edukim rreth shëndetit dhe aftësive për jetën.

3. Zhvillimi dhe shtimi i bashkëpunimit me ofruesit e shërbimit dhe partnerët e komunitetit për të mbështetur në mënyrë efektive shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve.

Zhvillimi organizativ dhe i komunitetit

1. Fuqizimin e kapaciteteve të organizatave për të përmirësuar shërbimet që u ofrojnë anëtarëve të tyre.

2. Fuqizimin e kapaciteteve të organizatave për të ofruar zhvillim profesional dhe mundësi angazhimi qytetar për anëtarët e komunitetit.

Mësimdhënia e gjuhës angleze

1. Rritja e kompetencave në gjuhën angleze dhe e kapacitetit për përdorimin e gjuhës angleze dhe praktikave të mësimdhënies me barazi gjinore.

2. Shtimi i arritjeve të nxënësve në gjuhën angleze dhe përforcimi i aftësive për jetën.

3. Rritja e aftësisë së anëtarëve të komunitetit për të mbështetur aksesin e nxënësve të nxënësve.

Projektet e KPSHMZ-së: Zhvillimi organizativ (ZHO)

Qëllimi i Projektit: Menaxhimi efektiv i zhvillimit të komunitetit nga individët, organizatat dhe komunitetet e fuqizuara shqiptare.

Projekti i KPSHMZ-së për zhvillimin organizativ synon të fuqizojë kapacitetin organizativ në nivel vendor përmes caktimit të Vullnetarëve në punë në agjenci qeveritare dhe OJQ. Vullnetarët promovojnë qasje të mbështetura në vlera për zhvillimin e komunitetit, angazhimin e shoqërisë civile, qeverisjes së mirë dhe krijimin e lidhjeve mes palëve të interesit.

Histori sukcesi: Rigjallërimi i sheshit Domino: Drejt një të ardhme të re të guximshme

VKP Rakesh së bashku me homologët vendas dhe mbështetjen e Vullnetarëve të tjerë për Zhvillimin Organizativ e kanë transformuar “Sheshin Domino” nga një zonë e neglizhuar në një hapësirë vibrante dhe të sigurt për më shumë se 10,000 banorë, duke përfshirë këtu të burgosur, nëna, fëmijë dhe anëtarë të komunitetit rom.

Veprimtaritë

Projekti u përfundua në faza të ndryshme. Në Ditën e Tokës të vitit 2023, vullnetarët mbollën bimësi dhe përgatitën sipërfaqet për vizatimin e muraleve, veprimtari që kulminoi me panairin e komunitetit. Në Ditën Ndërkombëtare të Aftësive Rinore, artistët e rinj shfaqën muralet e tyre dhe organizuan ceremoninë hapëse me muzikë, dhe me pjesëmarrjen e zyrtarëve të qytetit dhe përfaqësues të medias, për të festuar transformimin e parkut.

Ndikimi

Kjo u arrit me kontributin e më shumë se 100 vullnetarëve nga tre shkolla vendore, duke fuqizuar të rinjtë të advokojnë për një qytet më të gjelbër. Kjo nismë rezultoi në krijimin e një hapësire komunitare gjithëpërfshirëse e cila kontribuon në avancimin e veprimtarive sociale dhe argëtuese për banorët e Fushë-Krujës, veçanërisht për komunitetin rom. Sheshi tani ka vlerë të qëndrueshme falë përmirësimit të dyshemesë dhe përmirësimeve të tjera të infrastrukturës, si dhe shtimit të koshave dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme të kopshtit.



14 Vullnetarë shërbyen në këtë sektor gjatë viteve 2023/2024.

44 organizata komunitare të mbështetura nga Vullnetarët për të zgjeruar mundësitë për angazhim qytetar.

2428 pjesëmarrës në veprimtari vullnetare të organizuara nga Vullnetarët dhe homologët e tyre.

142 projekte të zbatuara nga Vullnetarët e ZHO-së dhe Homologët.

Projekti i KPSHMZ-së: Shëndeti dhe mirëqenia e të rinjve (ShMR)

Qëllimi i Projektit: Fuqizimi dhe informimi i fëmijëve dhe të rinjve për të pasur një jetë të shëndetshme dhe për t'u kthyer në të rritur produktivë dhe të përkushtuar.

Duke i caktuar *Vullnetarët në shkolla për të punuar krahas mësuesve dhe homologëve të komunitetit*, projekti ShMR synon të rrisë njohuritë dhe aftësitë e fëmijëve dhe të rinjve me qëllim përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së tyre, rritjen e kapaciteteve të stafit shkollor për të ofruar edukim mbi shëndetin dhe aftësitë për jetën dhe rritjen e bashkëpunimit me ofruesit e shërbimit dhe partnerët komunitarë.

Histori suksesi: Ndërgjegjësimi për mjedisin; projekti 'Serra'.

Bujqësia është një nga burimet kryesore të të ardhurave për fshatrat shqiptarë. VKP-ja Ashlyn, së bashku me Homologët e saj dhe nxënësit bashkuan forcat për të ndërtuar një serrë në oborrin e shkollës.

Veprimtaritë

Sipas trajnimit 'Hartim dhe Menaxhim Projekti' të organizuar nga KPSHMZ, Ashlyn dhe Homologët e saj bashkëpunuan për të realizuar propozimin e projektit për serrën. Ashlyn aktivizoi fëmijë dhe të rinj të talentuar të komunitetit të saj në 'Klubin e Mjedisit', ku janë organizuar veprimtaritë për mbledhjen e plehërave, riciklimin dhe mbjelljen e pemëve. Anëtarët e komunitetit bashkëpunuan ngushtësisht me stafin e shkollës për të mundësuar ndërtimin e serrës.

Ndikimi

Në fund të vitit shkollor, 180 fëmijë dhe anëtarët e komunitetit përmirësuan njohuritë dhe aftësitë e tyre rreth të ngrënit shëndetshëm, sigurisë ushqimore dhe ndërgjegjësisht për mjedisin. 100 nxënës u angazhuan në mënyrë aktive në Klubin e Mjedisit dhe kontribuan në përmirësimin e hapësirave të gjelbra në shkollë dhe komunitet.



17 vullnetarë shërbyen në këtë sektor gjatë viteve 2023/2024.

265 punonjës nga stafi i shkollave u orientuan drejt përdorimit të teknikave novatore për të lehtësuar kurrikulat me barazi gjinore për shëndetin dhe aftësitë për jetën

4193 pjesëmarrësve iu ofrua trajnim individual ose në grup mbi shëndetin dhe mirëqenien e të rinjve

Projekti i KPSHMZ-së: Mësimdhënia e gjuhës angleze në Shqipëri

Vështrim i përgjithshëm i projektit

Synimi i Projektit: Zhvillimi i kapaciteteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës angleze për nxënësit dhe mësuesit shqiptarë.

Programi për mësimdhënien e gjuhës angleze në Shqipëri synon të përmirësojë nivelin e kompetencave të mësuesve dhe nxënësve në gjuhën angleze, të rrisë kapacitetet e mësuesve për përdorimin e aftësive të përgjithshme të mësimdhënies dhe atyre të gjuhës angleze dhe të rrisë aftësitë e anëtarëve të komunitetit për të mbështetur mësimnxënien. Vullnetarët në Shqipëri së bashku me mësuesit shqiptarë japin mësim dhe zhvillojnë veprimtari jashtëkurrikulare si dhe projekte që synojnë t'i pajisin të rinjtë vendas me aftësi për jetën dhe aftësi drejtuese.

Veprimtaria e Vullnetarëve: *Shkruaj! - konkursi i shkrimit krijues*

Përveç mbështetjes së drejtpërdrejtë për mësuesit dhe nxënësit në klasa, Vullnetarët e mësimdhënies së gjuhës angleze realizojnë veprimtari që fuqizojnë dhe frymëzojnë krijimtarinë e nxënësve dhe i mësojnë atyre aftësitë e të menduarit kritik. Këtë vit, nën drejtimin e Vullnetarëve të mësimdhënies së gjuhës angleze Rylie dhe Kira, lançuan projektin *Shkruaj!*, i cili kulminoi me një konkurs në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Si rezultat, 1132 nxënës nga 30 komunitete praktikuan aftësitë e tyre të të shkruarit, u frymëzuan për të qenë krijues dhe garuan me bashkëmoshatarët e tyre në Shqipëri dhe më tej. Për mësuesit e anglishtes kjo ishte një mundësi për të zhvilluar aftësitë e nxënësve të tyre në gjuhën angleze nëpërmjet mënyrave që nxisin të menduarit të cilat shpesh nuk përfshihen në kurrikulë, dhe çfarë është më e rëndësishmja, *Shkruaj!* i dha mundësinë nxënësve të shprehen lirisht dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në gjuhën angleze.



Një mësuese e gjuhës angleze dhe një Vullnetare duke dhënë mësim së bashku në klasë

16 Vullnetarët shërbyen në sektorin e mësimdhënies së gjuhës angleze në vitet 2023/2024

193 mësues u mbështetën nëpërmjet projekteve brenda dhe jashtë klasës, trajnime dhe konferenca

812 të rinj morën pjesë në veprimtaritë për zhvillimin e të rinjve, organizuar nga Vullnetarët dhe homologët vendas

3679 nxënësve iu ofrua mësimdhënie e përbashkët e gjuhës angleze në klasa dhe klube, kampe apo veprimtari jashtëkurrikulare

Projekti i KPSHMZ-së: “TEFL” në Mal të Zi

Synimi i Projektit: Zhvillimi i kapaciteteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës angleze për mësuesit dhe nxënësit malazezë.

Përmes punës së Vullnetarëve të caktuar për mësimdhënie të përbashkët në shkollë në Mal të Zi, programi “TEFL” synon të përmirësojë nivelin e kompetencave të nxënësve dhe mësuesve në gjuhën angleze, të rrisë kapacitetet e mësuesve për përdorimin e aftësive të përgjithshme të mësimdhënies dhe atyre të gjuhës angleze. Gjithashtu, Vullnetarët në Mal të Zi mbështesin nevojën për veprimtari jashtëkurrikulare si dhe projekte që synojnë t’i pajisin të rinjtë vendas me aftësi për jetën dhe drejtues.

Histori suksesi - Fuqizimi i arsimtarëve dhe nxënësve: Përmirësimi i të nxënësve nëpërmjet trajnimit për njohuritë për multimedian.

Vullnetarja e Korpusit të Paqes, Angela së bashku me drejtorin dhe kolegët mësues në shkollë vunë në praktikë idenë e marrjes së një granti për të përmirësuar njohuritë kompjuterike të nxënësve, mësuesve, stafit dhe anëtarëve të përzgjedhur të komunitetit nëpërmjet trajnimit gjithëpërfshirës rreth multimedias. Nëpërmjet përvojave praktike të të nxënësve, pjesëmarrësit zhvilluan zotësi në përdorimin e aplikacioneve kompjuterike për detyra të ndryshme, duke përfshirë *menaxhimin e projektit, mbajtjen e shënimeve, prezantimet dhe përgatitjen e testeve*. Të pajisur me këto aftësi të përvetësuara, nxënësit mund të kalojnë pa problem dhe të jenë të suksesshëm në arsimin e lartë ose në fuqinë punëtore, ndërkohë që mësuesit dhe stafi do të jenë më mirë të pajisur për të integruar teknologjinë në klasat e tyre, duke rezultuar në rritjen e angazhimit të nxënësve dhe rezultate më të mira të të nxënësve.



Nxënësit duke marrë pjesë në trajnimin për njohuritë në multimedia në klasën e pajisur falë grantit të VKP-së Angela.

12 vullnetarë shërbyen në këtë sektor gjatë viteve 2023/2024.
586 nxënës morën pjesë në klubet jashtëkurrikulare të gjuhës angleze, seancat mësimore, dhe/ose kampet
2054 nxënës në klasat e Vullnetarëve treguan arritjet e tyre në gjuhën angleze.

Kampet verore në Shqipëri dhe Mal të Zi



"GLOW Code" në Shqipëri



"Taking the Lead" në Malin e Zi

Në Shqipëri dhe në Malin e Zi, Vullnetarët organizuan disa kampe verore me tema të ndryshme, të mbështetur edhe në nevojat specifike të shkollave vendore, organizatave dhe komuniteteve. Synimi i këtyre kampeve ishte të frymëzonin nxënësit e rinj të angazhohen me tema të lidhura me zhvillimin e komunitetit, duke përfshirë mendimin kritik, qeverisjen, ndërgjegjësimin mjedisor, teknologjinë dhe sportet/veprimtaritë argëtuese. Disa nga këto veprimtari përfshijnë shëtitjet në komunitet ose bashkëbisedimet informale në kafene duke krijuar të rinjve një hapësirë të sigurt ku të diskutojnë për marrëdhëniet, synimet në jetë dhe kufijtë personalë.

Disa shembuj të kampeve në vitin 2024 përfshijnë:

Kampi i aftësive për jetën; gati për klasën e parë!

Kampi 'Qyteti im i ardhshëm!'

Kampi 'Ecim së bashku': Kampet me bazë aftësitë

Kampi i Teatrit

Kampi i artit

Kampi 'Taking the Lead' - Kampi për certifikimin ndërkombëtar për njohuritë kompjuterike
Kampi veror i gjuhës angleze për fëmijë dhe të rritur
Aftësitë praktike në kompjuter

1063 pjesëmarrës në Shqipëri dhe Mal të Zi.

38 Kampe verore.

50% + e kampeve verore përfshinin aftësitë teknologjike dhe aftësitë e njohurive digjitale.

Kampet verore në Shqipëri dhe Mal të Zi

Gjatë muajve të verës Vullnetarët e KPSHMZ janë angazhuar në mënyrë aktive në zhvillimin e veprimtarive krijuese me fëmijët dhe të rinjtë. Një tipar kyç i këtyre përpjekjeve janë kampet verore, të cilat përfshijnë planifikim të kujdesshëm, bashkëpunim dhe zbatimin me aktorë të ndryshëm të komunitetit.

Kampet verore 'GLOW Code' ofruan një program dy javor ku vajzat mësojnë kodimin ndërsa zhvillojnë aftësi thelbësore drejtuese dhe fuqizuese.

Këto kampe prezantuan në mënyrë argëtuese dhe tërheqëse teknologjinë dhe drejtimin, duke i ndihmuar pjesëmarrësit të hedhin themele të forta të vlerave pozitive për të mbështetur aspiratat e tyre për të ardhmen.

Temat e mbuluara gjatë kampit përfshijnë:

- Prezantimin me drejtimin dhe kodimin, komunikimin dhe punën në ekip.
- Projektimin e produktit nëpërmjet planifikimit të qytetit.
- Krijimin e marrëdhënieve pozitive dhe vendosjen e synimeve SMART.
- Zhvillimin e aftësive plotësuese si të folurit në publik dhe komunikimi i efektshëm.



7 komunitete në mbarë Shqipërinë.

105 nxënës janë angazhuar në kampe.

30 anëtarë të komunitetit kontribuan në organizimin e kampeve.

25 VKP janë angazhuar

Një traditë prej komuniteteve malazeze

Nga: Vullnetari i Korpusit të Paqes Eric B.

Në komunitetin tim, iftari është vakti që hahet pas perëndimit të diellit gjatë muajit të Ramazanit dhe familjet, të afërmit, fqinjët dhe miqtë shpesh e festojnë atë së bashku.

Një ditë gjatë muajit të Ramazanit, njëra nga mësueset e shkollës më dërgoi një mesazh spontan dhe më pyeti nëse kisha ndonjë plan për darkë atë mbrëmje. “Jo,” iu përgjigja. Ajo u gëzua shumë dhe më njoftoi se burri i saj do të vinte të më merrte pas një ore! Vajza e saj ishte një nga nxënëset e mia të klasës së tetë dhe më vonë mësova se ishte ideja e saj të ftonte mësuesin Eric; ishte shumë e ëmbël dhe e sjellshme nga ana e saj. Nga përvojat e mëparshme me iftarin, e kuptova që do të kishte shumë njerëz, por nuk e kisha menduar se do të kishte kaq shumë. Teksa erdhën më shumë njerëz gjatë mbrëmjes, pashë nxënës të tjerë të mi dhe mësova se edhe prindërit e tyre ishin mësues. Pastaj erdhi edhe një burrë që zotëronte një nga dyqanet e vogla ushqimore në fshat. Me sa duket ishte kunati i dikujt. Atë natë të gjithë dukej se ishin të lidhur në ndonjë farë mënyre, ndoshta edhe ajo gruaja që punonte në furrë! Bashkëshorti i njërës prej mësueseve ishte politikan në qytet. Edhe hoxha ishte i ftuar, gjë që e bëri edhe më të veçantë mbrëmjen për familjen. Kishte aq shumë njerëz sa u desh të hanim në dy turne! Në dhomën e ndenjes, burrat u mbledhën veçmas nga gratë. Mbrëmja filloi me hurma të thata dhe pije, ndërsa përpara se të shkonim në dhomën e ngrënies të gjithë ndaluan në lavamanin në korridor për të larë duart. Në tavolinën e gjatë të ngrënies, unë isha ulur në cep ngjitur me hoxhën. Të gjithë ndaluan për një moment, ndërsa ai drejtoi faljen për atë mbrëmje.

Iftari është një rast për të festuar, pasi i gjithë komuniteti agjëron dhe të gjithë e çelin agjërimin së bashku. Iftari është si darka e Ditës së Falënderimeve, por disa herë në muaj, me ushqim të bollshëm dhe teprica edhe për ditët në vijim. Çdo iftar ku mora pjesë ishte ndryshe, por ishte kënaqësi që më ftuan dhe më mirëpritën në shtëpitë e tyre.



Prezantojmë rreth ushqimit në Shqipëri



Haley duke bërë byrek

Nga: Vullnetarja e Korpusit të Paqes Haley H.

Mbaj mend se gjëja e parë që kontrollova kur iu bashkova Korpusit të Paqes ishte se çfarë lloj ushqimi ka në Shqipëri. E dija që nëse do të jetoja diku për dy vjet, duhet të më pëlqente ushqimi! Pas mbërritjes, një nga ushqimet e para që hëngra ishte byreku dhe ai tashmë është kthyer në një gatim kryesor në dietën time. Ndonjëherë më hahet vërtetë shumë. Jo vetëm që byreku është i shijshëm, por është një ushqim që bashkon të gjitha traditat e Shqipërisë. Nëse po vijnë miq për vizitë, apo po nëse vëllezërit do nisen për në Tiranë, ose në ditë feste ose thjesht në një ditë normale në lagje, duhet të ketë patjetër byrek. Jo vetëm kjo, por nëse gatuhet në mënyrën tradicionale byreku do goxha kohë të bëhet. Përgatitja e petës së hollë së secilës shtresë është një moment i shkëlqyer për të biseduar. Shtresat duan minimalisht një orë, nëse e di se çfarë po bën... Mamaja pritëse pati shumë durim me mua teksa hapja brumin për petat sa më hollë dhe sa më të lëmuara, siç më tregoi ajo. Ajo e bënte aq lehtësisht, sa nuk arrija as ta kuptoja. Pasi bën të gjitha shtresat mund ta mbushësh me shijen që preferon: djathë, mish, spinaq ose çfarë t'ju dojë zemra. Ngjan disi me lazanjën, të paktën kështu ia përshkrova unë mamit tim pritëse. Pastaj, pasi i kemi shtruar petët me kujdes, e fusim në furrë që të bëhet krokant dhe i shijshëm. Tridhjetë minuta më pas do të keni vaktin më të shijshëm dhe familjar që mund të keni provuar ndonjëherë. E di se kur të kthehem në Shtetet e Bashkuara nuk do të mund të rri pa të...sa mirë që kam një mami të mirë pritëse që më mëson!

Ndajmë veprimtari novatore amerikane

Ja se si e nisëm konkursin e parë të germëzimit në anglisht në shkollën tonë: Udhëzues

Në pranverë të vitit 2023, një shkollë fillore në Mal të Zi zhvilloi për herë të parë konkursin e germëzimit në anglisht. Ky ishte një aktivitet i nxitur nga kërkesat e nxënësve dhe i drejtuar nga Eric, Vullnetari i Korpusit të Paqes, i cili punonte në shkollë si mësues i gjuhës angleze. Së bashku me kolegët të tij të përkushtuar vendas, drejtuan nismën, që synonte të përmirësonte drejtshkrimin, fjalorin, shqiptimin dhe vetëbesimin, duke mundësuar një konkurrencë të shëndetshme për nxënësit nga klasa e katërt deri në klasë të nëntë. Pjesëmarrja ishte e detyrueshme për t'u siguruar që të gjithë nxënësit ta përjetonin sfidën dhe emocionin e aktivitetit.

Konkursi ishte i strukturuar në tre raunde: brenda klase, mes klasave dhe në nivel rajonal. Raundet brenda klasës nisën me dy seanca praktike për t'i ndihmuar nxënësit të njiheshin me formatin dhe për të rrisin vetëbesimin e tyre. Për klasat e katërta dhe të pesta, u përdor një sistem më mbështetës, dhe nxënësit që i germëzuan saktë fjalët morën "tick", duke ofruar përfundim pozitiv dhe një qasje joeliminuese.

Konkursi mes klasave u zhvillua në bibliotekën e shkollës me pesë nga nxënësit më të mirë të çdo klase, me rregulla dhe afate kohore më të rrepta. Fituesit morën certifikata dhe aktiviteti u përmbyll me një konkurs në nivel rajonal me një tjetër shkollë fillore, ku nxënës me prejardhje të ndryshme gjuhësore konkurruan me sukses.

Konkursi i germëzimit ishte organizuar me kujdes dhe përfshinte shumë role: prezantuesin, jurinë, llogaritësin e kohës dhe një sistem të qartë për drejtësinë. Nxënësit u përgatitën duke praktikuar germëzimin, duke mësuar alfabetin e gjuhës angleze dhe duke studiuar listat e fjalëve. Mësuesit, i përfshinë aktivitetet e germëzimit në orët e zakonshme mësimore. Kjo nismë e suksesshme jo vetëm që ishte një përvojë frytdhënëse arsimore, por shërbeu edhe si dëshmi e ndikimit të vullnetarëve të Korpusit të Paqes, që punojnë së bashku me mësuesit vendas për të përmirësuar aftësitë e nxënësve në anglisht dhe për të nxitur një ndjenjë komuniteti. Ky aktivitet hodhi themele të forta për aktivitetet e ardhshme dhe konkurset e germëzimit në shkollë.



Spelling Bee!

- Study the word lists in the back of your workbooks and the extra words in the back of your student books.
- You might have to spell a different form of a word. For example, if the word *make* is in the book, you might have to spell *make*, *makes*, *making*, or *made*.

Rules

- You will hear the word two times before you spell it.
- Say the word, then spell the word, then say the word again.
 - EXAMPLE: "Water. W – A – T – E – R. Water."
- Speak slowly, clearly, and loud enough.
- Use English letter names only.
- You have 1 minute to spell the word.

Options. You can use most of these only one time.

- Ask to repeat the word. *You can do this two times.
- Ask to hear the word used in a sentence.
- Ask for a definition or the meaning of the word.
- Ask for the part of speech of the word (noun, verb, adjective, adverb, preposition).
- Start over.
 - You must say, "Start over".
 - If you already made a mistake, you can't start over.

Elimination. You will be out if you misspell the word, if you take too long to spell the word, if you do not use English letters, and if you do not speak clearly.

Winning. When there are two people left, if the other person misspells the word, you must spell your own word correctly to win.

Studying and preparing

- Study the word lists at the back of the workbook. Study the extra words at the back of the student book. Study all the words in the units.
- Study English spelling rules. Look for spelling patterns.
- Study how verbs change in different tenses and how nouns become plurals.
- Use an online spelling game.
- Practice with a friend or family member.
- Practice spelling out loud.
- Practice writing the words.
- Practice saying the English alphabet names.



Udhëzues për Konkursin e Germëzimit

Modele novatore shërbimi dhe shërbim i rikonceptuar: -Shërbimi virtual-

Nisma për shërbim virtual:

Në vitin 2020, Korpusi i Paqes prezantoi Platformën Pilot për Shërbime Virtuale (PPSHV) si një mënyrë novatore për të vazhduar misionin dhe synimet e KP-së edhe gjatë pandemisë së COVID-19. PPSHV-ja u projektua për të provuar realizueshmërinë e angazhimit virtual dhe si fillim ishte e hapur për çdo Vullnetar të Kthyer të Korpusit të Paqes. Kohët e fundit, angazhimet e Shërbimit Virtual janë të hapura për të gjithë qytetarët amerikanë që dëshirojnë të ofrojnë shërbimet e tyre vullnetare. Pjesëmarrësit në Platformën Pilot për Shërbime Virtuale (PPSHV) janë qytetarë, që ia ofrojnë kohën dhe shërbimet e tyre vullnetare agjencisë për t'u bërë virtualisht pjesë e angazhimeve pesë deri në pesëmbëdhjetë orë në javë me partnerë të komunitetit për një periudhë prej tre deri në gjashtë muaj.

Shërbimi virtual në Shqipëri dhe Mal të Zi:

Që në fillim të Platformës Pilot për Shërbime Virtuale në vitin 2020, Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi ka krijuar 13 angazhime për Shërbime Virtuale në bashkëpunim me organizata partnere vendase në të dyja vendet, nga të cilat 12 kanë përfunduar. Këto angazhime i kanë mundësuar KPSHMZ-së të krijojë partneritete dhe të mbështesë partnerët aktualë e organizatat partnere në Tiranë ose Podgoricë, ku VKP-të nuk mund të shërbejnë.

Trembëdhjetë individët, që ia kanë dedikuar kohën e tyre shërbimit virtual, kanë kontribuar në aktivitete të lidhura me zhvillimin e kurrikulës, përvetësimin e gjuhës angleze, zhvillimin e drejtuesve, mbledhjen e fondeve, e shumë të tjera. Që prej janarit të vitit 2024, janë në proces zbatimi tre angazhime për Shërbime Virtuale.



Mbi shërbimin virtual në vitin 2024

- 12** angazhime për Shërbime Virtuale në Shqipëri dhe Mal të Zi që nga fillimi i pilotimit me shkollat, institucionet e arsimit të lartë, OJQ-të dhe agjencitë qeveritare.
- 1** angazhim i Shërbimit Virtual është në zbatim

Modele novatore shërbimi dhe shërbim i rikonceptuar

-Komiteti i Përmirësimit të Shërbimit-

Komiteti i Përmirësimit të Shërbimit

Në vitin 2024 Komiteti i Përmirësimit të Shërbimit (KPSH) vijoi me rolin e rëndësishëm si një platformë për dialog konstruktiv mes stafit të Korpusit të Pagues dhe Vullnetarëve. Ky komitet bën bashkë nga një vullnetar për çdo sektor në Shqipëri dhe Mal të Zi të zgjedhur nga kolegët e tyre për të ofruar njohuri dhe vlerësime për mënyrën se si mund të përmirësojmë programimin, trajnimin dhe operacionet tona. Përmes takimeve tremujore dhe angazhimit të vazhdueshëm, komiteti lehtëson me efikasitet diskutimet për çështjet shqetësuese të komunitetit të KPSHMZ-së.

Falë përpjekjeve të palodhura të vullnetarëve, përfshirë Amelia, Paul, Sebastian, Parker, Katie, Maria, Angela dhe Rylie, KPSH-ja është bërë mekanizëm thelbësor për nxitjen e mbështetjes reciproke dhe për të siguruar që synimet e Korpusit të Pagues të përputhen njësoj me nevojat e vullnetarëve dhe të komunitetet pritëse. Përcjellim vlerësimet tona të veçanta për kryetaren Katie në ikje dhe kryetaren e re Rylie!



Anëtarët e Komitetit të Përmirësimit të Shërbimit dhe drejtuesit e KPSHMZ-së në vitin 2024

Modele novatore shërbimi dhe shërbim i rikonceptuar

-Rrjeti i Mbështetjes nga Kolegët-

Rrjeti i Mbështetjes nga Kolegët

Rrjeti i Mbështetjes nga Kolegët (RRMK) luan rol kyç në mbështetjen e mirëqenies mendore dhe emocionale të vullnetarëve të Korpusit të Paqes. Ky grup i formalizuar i vullnetarëve të trajnuar ofron mbështetje thelbësore nga kolegët, duke mundësuar një hapësirë të sigurt dhe konfidenciale që individët të tregojnë sfidat dhe të kërkojnë këshilla. RRMK-ja promovon qëndrueshmërinë dhe lidh vullnetarët me burimet e duhura, sipas nevojës, qoftë për mirëqenien personale apo për udhëzimet profesionale.

Gjithashtu, RRMK-ja bashkëpunon ngushtë me Ekipet Mjekësore dhe të Sigurisë për të trajtuar shqetësimet e konstatuara dhe për të forcuar infrastrukturën e përgjithshme të mirëqenies.

U përcjellim falënderime të veçanta anëtarëve të ekipit si Abigail, Kira, Aleksandra, Adrell, Patti, Kourosh dhe Robert për angazhimin e tyre për nxitjen e një kulture kujdesi dhe empatie. Përmes punës së saj, RRMK-ja ka ndikuar në përvojën e Vullnetarëve, duke ndihmuar për të siguruar që Vullnetarët të ndihen të mbështetur, të fortë dhe të përgatitur për të kapërcyer sfidat e veçanta të shërbimit.



Anëtarët e RRMK-së së Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi bashkëpunuan me punonjësit tanë të shëndetësisë gjatë vitit 2024

Modele novatore shërbimi dhe shërbim i rikonceptuar

-Grupi i Punës për Komunikimet-

Grupi i Punës për Komunikimet

Në vitin 2024, Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi vijuan bashkëpunimin me Grupin dinamik të Punës për Komunikimet, duke bërë bashkë stafin dhe vullnetarët për të rritur bashkëpunimin dhe për të zgjeruar ndikimin e përpjekjeve të tyre në komunitetet vendase.

Një nga mjetet më efektive të grupit ka qenë kontakti me vullnetarët kolegë për të ndarë përditësimet dhe për të shfaqur arritjet përmes mediave sociale, duke siguruar që audienca e jashtme dhe komunitetet vendase të jenë të informuara dhe të angazhuara. Gjithashtu, grupi ka luajtur rol të rëndësishëm në përmirësimin e komunikimeve të brendshme përmes buletinit dy-javor, që shërben si burim thelbësor që vullnetarët dhe stafi të jenë lidhur dhe të informuar për projektet dhe nismat në vijim.

Përmes nxitjes së komunikimit të jashtëm dhe dialogut të brendshëm, Grupi i Punës për Komunikimet ka forcuar lidhjen mes Korpusit të Paqes dhe komuniteteve të cilave u shërben, duke rritur vizibilitetin dhe ndikimin e punës vullnetare në rajon.



Në vijim të një ftese nga Grupi i Punës për Komunikimet, Vullnetarët dhe nxënësit e tyre propozuan dizajne për një pikturë murale jashtë zyrës së Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi. Propozimi i mësipërm doli fitues në konkurs dhe aktualisht zbukuron murin e zyrës sonë. Falënderojmë VKP-në Eric dhe nxënësit për dizajnin fitues!

Mbështetja administrative efektive e operacioneve të Korpusit të Paqes

Në vitin 2024, Njësia e Operacioneve të Administrimit dhe Menaxhimit të Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi luajtën rol vendimtar në sigurimin e funksionimit normal të operacioneve të përditshme, duke u mundësuar vullnetarëve dhe stafit të përqendrohen në misionin e paqes dhe miqësisë. Puna e tyre në prapaskenë mbështet çdo pjesë të operacioneve të Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi, që nga menaxhimi i logjistikës dhe strehimit e deri te mbikëqyrja e operacioneve financiare dhe pajtueshmëria me rregulloret vendore.

Një nismë e spikatur këtë vit ishte ndërthurja e suksesshme e mjeteve të reja digjitale si PEEPS për të thjeshtuar proceset e krijimit të grafikëve, duke ia bërë më të lehtë stafit menaxhimin e detyrave dhe gjurmimin dhe raportimin e ecurisë.

Gjithashtu, njësia lehtësoi mundësitë për zhvillim profesional dhe organizim aktiviteteve duke i ndihmuar vullnetarët dhe stafin të ndërtojnë aftësi që do t'u nevojiten gjatë dhe pas shërbimit të tyre në Korpusin e Paqes. Angazhimi i tyre për të krijuar një mjedis operacional të mirorganizuar, të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm ka qenë thelbësor për forcimin e pranisë dhe ndikimit të Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi.



Gjatë vitit, stafi merr pjesë në trajnime të vazhdueshme, por edhe në aktivitete për mirëqenien.

Ofrimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse mjekësore për Vullnetarët tanë

Shëndeti dhe mirëqenia e Vullnetarëve të Korpusit të Paqes, që shërbejnë në Shqipëri dhe në Mal të Zi, janë shumë të rëndësishme për ne. Vullnetarëve u mundësohet i gjithë kujdesi mjekësor i nevojshëm dhe i duhur gjatë shërbimit në Korpusin e Paqes. Punonjësi i shëndetësisë i Korpusit të Paqes (PSHKP) në Vendlodhje nën mbikëqyrjen administrative të Drejtores për Vendlodhje dhe me udhëzimet dhe mbikëqyrjen profesionale nga Zyra e Shërbimeve Mjekësore në Korpusin e Paqes Uashington menaxhon dhe zbaton një program gjithëpërfshirës për kujdesin shëndetësor.

Programi i kujdesit shëndetësor përfshin:

- Imunizimi dhe profilaksia para shërbimit siç përshkruhet në Udhëzimet Teknike të Zyrës së Shërbimit Mjekësor dhe imunizimi dhe profilaksia e rregullt, sipas nevojës, gjatë gjithë periudhës së shërbimit.
- Kujdes klinik gjatë gjithë shërbimit.
- Orientim shëndetësor dhe edukim gjatë gjithë shërbimit.

Vlerësim të kushteve shëndetësore në vendet e mundshme të caktimit të Vullnetarëve

- Mbështetje tjetër shëndetësore për Vullnetarët në vendet e tyre përmes vizitave të stafit në terren, sipas nevojës.

I gjithë kujdesi dhe shërbimet e nevojshme mjekësore ofrohen kryesisht nëpërmjet, ose nën drejtimin, e PSHKP-ve dhe përmes ofruesve vendas të kujdesit shëndetësor, sipas nevojës.

Qasja në kujdesin mjekësor: Punonjësit e Shëndetësisë të Korpusit të Paqes shqyrtojnë problematikat shëndetësore të vullnetarëve duke vlerësuar emergjencën dhe duke ofruar këshilla nëpërmjet telemjekësisë dhe paketës mjekësore të VKP-së. Nëse nevojitet kujdes personal, ata përcaktojnë nëse vullnetari duhet të vizitohet nga ata, nga një PSHKP në gatishmëri ose një ofrues vendas. Ata shqyrtojnë historikun mjekësor, kryejnë ekzaminime fizike dhe diskutojnë opsionet e trajtimit.

Trajnimi mjekësor: Vullnetarët marrin trajnim mjekësor gjatë aktiviteteve të trajnimit para shërbimit, gjatë shërbimit dhe pas shërbimit. PSHKP-të u mësojnë atyre rreth ruajtjes së shëndetit, përfshirë ndihmën e parë, parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve të zakonshme. Trajnimi, krahas tematikave të tjera, mbulon COVID-19, ushqyerjen, sigurinë ushqimore dhe të ujit, shëndetin emocional, ndërgjegjësimin për alkoolin, parandalimin e HIV/AIDS dhe SST-ve të tjera, dhunën në familje, reagimin në rast emergjence.



Ekipi mjekësor i Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi me kolegët nga Selia Qendrore dhe Drejtorin për Vendlodhje.

Siguria dhe sigurimi i Vullnetarëve të Korpusit të Paqes dhe Fuqizimi i stafit përmes ekspertizës në siguri dhe sigurim

Korpusi i Paqes është në dijeni të risqeve që përfshin shërbimi vullnetar. Mirëqenia e përgjithshme e një Vullnetari është përgjegjësi e përbashkët për zbutjen e risqeve. Anëtarët e komunitetit, stafi i Korpusit të Paqes dhe Vullnetarët luajnë të gjithë një rol. Duke qenë se Korpusi i Paqes nuk mund t'i eliminojë të gjitha risqet me të cilat mund të përballen vullnetarët dhe, siguria dhe sigurimi i Vullnetarëve është me rëndësi të madhe, ekzistojnë programe, burime dhe sisteme për t'i mbështetur Vullnetarët gjatë gjithë shërbimit.

Ekipi i Sigurisë dhe Sigurimit i KPSHMZ-së është përgjegjës për punën me pjesën tjetër të stafit dhe partnerët e sigurisë dhe sigurimit për të zbatuar zgjidhje racionale dhe praktike për problemet e sigurisë dhe sigurimit me të cilat vullnetarët dhe të trajnuarit mund të përballen gjatë shërbimit të tyre.

Korpusi i Paqes është angazhuar për t'u ofruar Vullnetarëve trajnimin, udhëzimet, mbështetjen dhe informacionet, që u nevojitet për të qenë të shëndetshëm, të sigurt dhe produktiv gjatë gjithë shërbimit të tyre. Qasja e gjerë dhe sistematike e Korpusit të Paqes për t'i mbajtur Vullnetarët të sigurt gjatë shërbimit të tyre mbështetet në disa parime themelore të sigurisë dhe sigurimit të Vullnetarëve, përfshirë

- ndërtimin e marrëdhënieve,
- shpërndarjen e informacioneve dhe trajnimin,
- zhvillimin e vendit,
- raportimin e incidenteve dhe reagimin; dhe
- planifikimin dhe komunikimet për emergjencat.

Vullnetarët mbështeten 24/7 dhe të gjitha sistemet e emergjencës janë plotësisht funksionale gjatë gjithë kohës përfshirë sistemin e Nëpunësit në Detyrë, Ndërlidhësit për Sulmet Seksuale dhe mbështetjen për VKP-të që udhëtojnë jashtë vendit të tyre.



Ekipi i Sigurisë dhe Sigurimit duke ofruar trajnime për Vullnetarët

Siguria dhe sigurimi i Vullnetarëve të Korpusit të Paqes dhe Fuqizimi i stafit përmes ekspertizës në siguri dhe sigurim

Programi i KPSHMZ-së për Sigurinë dhe Sigurimin

Korpusi i Paqes monitoron nga afër, në mënyrë të vazhdueshme, mjedisin e sigurisë dhe sigurimit në çdo vend ku shërbejnë vullnetarët.

Ekipi i Sigurisë i Korpusit të Paqes në bashkëpunim dhe në konsultim me autoritetet kryesore të sigurisë dhe sigurimit në vendin e shërbimit kryen vlerësime vjetore të hollësishme të riskut për kërcënime të mundshme ndaj Vullnetarëve dhe Vendndodhjes si: fatkeqësitë natyrore (tërmetet, përmybtjet, zjarret, dëbora/stuhitë), aksidentet rrugore, sëmundjet epidemiologjike, terrorizmi dhe rreziqe të tjera, të cilat mund të kenë ndikim të mundshëm në mirëqenien e Vullnetarëve dhe operacionet e Vendndodhjes.

Si rezultat i këtij vlerësimi të thelluar për sigurinë, Vendndodhja përgatit Planin e Veprimit për Emergjencat (PVE), ku përshkruhen të gjitha masat zbutëse për të ulur probabilitetin e riskut, gatishmërinë, veprimet për t'u përballur me kërcënimin dhe të gjitha hapat/veprimet e reagimit nëse kërcënim i pashmangshëm. Gjithashtu, në bazë të vlerësimit të riskut bëhen përshtatjet për caktimin e Vullnetarëve në komunitete të ndryshme në të gjithë vendin, si dhe politikat, trajnimet, transporti dhe komunikimi në raste emergjence.

Si e mbështet stafi brenda vendit sigurinë dhe sigurimin e vullnetarëve?

Monitorimi i Mjedisit të Sigurisë dhe Sigurimit – Ekipi i Sigurisë monitoron çdo ditë, mjedisin e sigurisë dhe sigurimit në Shqipëri dhe Mal të Zi dhe ofron rekomandime ose masa zbutëse në kohë për Drejtoren për Vendin, Ekipin e Reagimit, stafin dhe selinë. Më pas, harton dhe ofron këshilla për sigurinë dhe sigurimin për stafin/Vullnetarët, sipas nevojës, për të zbutur risqet ose kërcënimet e mundshme për Vullnetarët ose operacionet në vendndodhje.

Ndërtimi i marrëdhënieve – Gjatë gjithë vitit, Ekipi i Sigurisë ndërton dhe ruan marrëdhëniet dhe të bashkëpunon me aktorët kryesorë të sigurisë dhe sigurimit në të dy vendet (zbatimi i ligjit, ambasadat, Agjencitë e Mbrojtjes Civile, Kryqi i Kuq) për mbështetjen në kohë të të Trajnuarve/Vullnetarëve në rast nevojë.

Vlerësimi i vendeve të punës dhe të strehimit: Stafi brenda vendit vlerëson dhe miraton komunitetet ku jetojnë dhe punojnë vullnetarët për t'u siguruar që vendet janë të përshtatshme dhe për të garantuar se vendet e punës dhe të strehimit janë të sigurta. Stafi i Korpusit të Paqes viziton vullnetarët në vendet e tyre për të monitoruar shëndetin dhe sigurinë e tyre. Nëse siguria ose mirëqenia e vullnetarëve cenohet ose vihet në rrezik, stafi i Korpusit të Paqes punon për ta zgjidhur situatën dhe për të ofruar mbështetje në kohë për viktimat e krimit.

Siguria dhe sigurimi i Vullnetarëve të Korpusit të Paqes dhe Fuqizimi i stafit përmes ekspertizës në siguri dhe sigurim

Trajnimi për sigurinë dhe sigurimin

Ekipi i Sigurisë dhe Sigurimit sigurohet që Vullnetarët, Trajnuesit dhe stafi të jenë të trajnuar siç duhet për përgjegjësitë e tyre lidhur me sigurinë dhe sigurimin dhe që të jenë në gjendje t'i zbatojnë ato.

Korpusi i Paqes përdor një qasje të integruar për sigurinë dhe sigurimin e Vullnetarëve. Përmes qasjes së integruar, ofrojmë rregullisht trajnime për sigurinë dhe sigurimin për të Trajnuarit/Vullnetarët, Homologët, Familjet Pritëse dhe stafin.

Përpara se të caktohen në komunitetet ku do të jetojnë dhe punojnë, të Trajnuarit ndjekin deri në 12 javë trajnime intensive para shërbimit në vendin e tyre të shërbimit. Temat përfshijnë gjuhën, kulturën, shëndetin dhe sigurinë dhe sigurimin.

Gjatë trajnimit për Sigurinë dhe Sigurimin, me qëllim përgatitjen e Vullnetarëve për mjedisin e ri, mbulohen disa tema si reduktimi i Riskut të Sigurisë, Siguria nga Transporti, Siguria në Shtëpi, Gatishmëria ndaj Tërmeteve, Plani i Veprimtimit për Emergjencat, Ndërgjegjësimi dhe Raportimi për Sulmet Seksuale, Rolet Gjimore, Ndërhyrjet Vëzhguese, Vëmendja e Padëshiruar etj.

Të Trajnuarit ndërgjegjësohen për mjedisin e tyre të ri, rrisin kapacitetin e tyre për të përballuar sfidat që mund të hasin dhe praktikojnë aftësi që i ndihmojnë ata të kenë një mënyrë jetese të sigurt dhe të përshtatshme. Të Trajnuarit udhëzohen edhe lidhur me politikat dhe procedurat e Korpusit të Paqes dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse.

Pas betimit, Korpusi i Paqes ofron trajnime të integruara për sigurinë gjatë gjithë shërbimit vullnetar për t'i ndihmuar vullnetarët ta njohin më vendin përreth dhe të krijojnë strategji personale të sigurisë.

Gjithashtu, Ekipi i Sigurisë mundëson trajnime dhe workshop-e të ndryshme për sigurinë dhe sigurimin me homologët e Vullnetarëve/anëtarët e komunitetit dhe anëtarët e familjes pritëse.

Gjithashtu, Ekipi i Sigurisë ofron/lehtëson çdo vit një sërë trajnimesh për sigurinë dhe sigurimin me tematika të ndryshme për stafin e Vendndodhjes.



Gjatë trajnimit para shërbimit

Stafi ynë i përherëshëm gjatë vitit 2024

Korpusi i Pages Shqipëri dhe Mali i Zi krenohet me stafin e dedikuar të përbërë nga amerikanët, shqiptarët dhe malazezët, ndër më të talentuarit e të dyja vendeve ku shërbejmë. Ekipi ka në fokus ofrimin e ndihmës për Vullnetarët tanë në mënyrë që të arrijnë potencialin e tyre të plotë gjatë shërbimit. Ata janë të emocionuar për punën e tyre dhe që do të bëjnë diferencën për fëmijët, komunitetet dhe njerëzit në Shqipëri dhe Mal të Zi. Ky është ekipi përgjegjës për punën e mirë që kemi bërë në Shqipëri që nga viti 1992 dhe për menaxhimin e mundësisë së re për të shërbyer në Mal të Zi.

Agim Dyrmishi	Jeffery Warner
Arben Cako	Jelena Tripkovic
Arben Loci	Julian Pando
Ardita Qosja	Luka Bobicic
Artenca Collaku	Lumturi Piciri
Benard Babaj	Marie
Besa Arapi	Aughenbaugh
Darina Kaltani	Marjeta Zavalani
Diana Djaloshi	Megan Wilson
Dorontinë	Milena Pejovic
Berishaj	Mira Luca
Elsona Tuncer	Mirela Tahiraj
Florian Muhaj	Monika Mukja
Gentian Leka	Qazim Hoxha
Geri Martiri	Rikela Fusha
Illir Memlikaj	Suida Shima
Illir Ziu	Tiana Covic
Iris Dollia	Ylli Cupi
Ivana Rackovic	



Anëtarët e stafit në një event për zhvillimin e ekipit në prill të vitit 2024

Organizatat Partnere të KPSHMZ-së

Organizata jo qeveritare (OJQ)

- Agro-Puka
- Fondacioni i Zhvillimit të Kapaciteteve Vendore Shqiptare
- Këshillat Amerikanë
- Qendra ARKA-Shkodër
- CSDC Durrës
- Darien Book Aid
- Shoqata e Mësuesve të Gjuhës Angleze
- Unioni i Anglishtfolësve
- Fondacioni Food Bank Albania
- Friends of Albania
- Junior Achievement Shqipëri
- Mary Ward Loreto
- Fëmijët janë e ardhmja (FJA)
- Qendra Konsumatori Shqiptar (QKSH)
- New Bridges
- Qendra "Marrëdhënie"
- Agjencia e Zhvillimit Rajonal-Korçë
- Sidi Education
- Terre des Hommes
- Touristic Dibra
- Water Charity
- World Association of Girl Guides and Girl Scouts
- World Connect
- World Vision
- Qendra rinore —Vlorë
- Youth in Free Enterprise

Organizata qeveritare dhe të pavarura

- Ministria e Arsimit dhe Sporteve
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit e Malit të Zi
- ASCAP (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar - Shqipëri)
- DPAP(Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar - Shqipëri)
- Drejtoria Arsimore e Rajonit të Veriut, Shqipëri
- Projekti "Shëndet për të Gjithë" - Shqipëri
- Shoqata e Paraplegjikëve e Malit të Zi
- Instituti Shqiptar i Shëndetit Publik
- Forum MNE
- Shoqata e Mësuesve të Gjuhës Angleze e Malit të Zi
- Ministria e Punëve të Jashtme e Malit të Zi
- Ministria e Punëve të Brendshme e Malit të Zi
- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) në Shqipëri dhe Mal të Zi
- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
- Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
- Ambasadat e Shteteve të Bashkuara në Shqipëri dhe Mal të Zi dhe Këndet Amerikane
- Universiteti i Shkodrës, Departamenti i Gjuhës Angleze
- Universiteti i Tiranës, Departamenti i Gjuhës Angleze


Bashkitë dhe shkollat

Shprehim vlerësimet tona për shkollat dhe bashkitë partnere në Shqipëri dhe në Mal të Zi.

Organizatat Partnere të KPSHMZ-së

Organizata jo qeveritare (OJQ)

- Qendra Epoka e Re
- Qendra Mjedisore Për Studime dhe Zbatime-
- SOS Fshatrat e Fëmijëve - Tiranë dhe Shkodër
- Tjetër Vizion-
- Open Gov Hub Albania
- Shoqata e Zhvillimit të Lidershipit për Ballkanin
- YEC
- Qendra Psiko-Sociale “Vatra”
- Agjencia e Zhvillimit Rajonal -
- Argonaut - Tepelenë
- Përfshirja Sociale për Zhvillim
- Qendra “Lëvizja Rinore”
- Qendra Internacionale për Solidaritet
- Youth of Ura
- Qendra Komunitare Nishtulla
- Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare
- Me Komunitetin për Ndryshim
- Porta Rome për Integrim





Zyra e KPSHMZ-së në Shqipëri

Rr. Besnik Sykja, Godina 2
Hyrja 1, Kutia Postare 8180
Tiranë, Shqipëri.
Tel: +355 42 365 5033

Zyra e KPSHMZ-së në Mal të Zi

19. decembar 5, stadion pod Goricom,
sjeverna tribina 81000,
Podgoricë, Mali i Zi.
Tel: +382 (0) 20674509

Faqja e internetit:

peacecorps.gov/albania-and-montenegro/

Facebook:

facebook.com/albania.peacecorps
facebook.com/peacecorpsinmontenegro

Instagram:

na gjeni duke kërkuar: @peacecorpsalbania
na gjeni duke kërkuar:
@peacecorpinmontenegro

E-mail:

AL-information@peacecorps.gov